

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE

Nr.Br.No: 04-935/2
Data / Datum / Date: 20/06/2024
Shtojca / Dodaci / Annex: -2-
PRISHTINE/A



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 150/2024

Datë: 20/06/2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në pajtim me nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës dhe të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitat e Rregullores MD-nr.07/2023 për procedurën e përcaktimit dhe verifikimit të reciprocitetit, kushtet, përmbajtjen dhe mënyrën e mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për fitimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme nga të huajt në Kosovë, si dhe në përputhje me nenin 3 të Rregullores MD-nr. 03/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores MD-nr.07/2023 për procedurën e përcaktimit dhe verifikimit të reciprocitetit, kushtet, përmbajtjen dhe mënyrën e mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për fitimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme nga të huajt në Kosovë, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Ministria e Drejtësisë bazuar në shkresën [redacted], të datës 18 tetor 2023 të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Turqisë *konfirmon* se [redacted] shtetas i Republikës së Turqisë mund të jetë titullar i të drejtave pronësore në Republikën e Kosovës në pajtim me kufizimet e të drejtave pronësore në pronën e paluajtshme për personin e huaj të përcaktuar në Ligjin nr. 08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës.
2. Kufizimet ligjore për fitimin e të drejtës pronësore në pronën e paluajtshme sipas legjislacionit përkatës të Republikës së Turqisë për shtetasit e Republikës së Kosovës, të cilat nuk i përcakton legjislacioni përkatës në Republikën e Kosovës do të zbatohen edhe për shtetasin turk nga pika 1 e këtij vendimi në Kosovë në pajtim me parimin e reciprocitetit.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe vlen një (1) vit nga dita e plotfuqishmërisë së tij.

Arsyetim

[REDACTED] me nr. identifikues [REDACTED] ka parashtruar në Ministrinë e Drejtësisë kërkesën nr. 04-935, të datës 10.05.2024 për dhënien e pëlqimit për fitimin e të drejtave pronësore në Republikën e Kosovës.

Ministria e Drejtësisë, ka shqyrtuar kërkesën e [REDACTED] për përcaktimin e reciprocitetit për fitimin e të drejtës së pronësore në Republikën e Kosovës dhe shkresat tjera të lëndës të bashkëngjitura dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës, dhe në pajtim me nenin 3 të Rregullores MD-nr. 03/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores MD-nr.07/2023 për procedurën e përcaktimit dhe verifikimit të reciprocitetit, kushtet, përmbajtjen dhe mënyrën e mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për fitimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme nga të huajt në Kosovë, ka marrë informacionet përkatëse për fitimin e të drejtave pronësore të shtetasve të huaj sipas legjislacionit të Republikës së Turqisë.

Bazuar në shkresën [REDACTED] të datës 18 tetor 2023 të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Turqisë, në të cilën ndër të tjera potencohet se "Në bazë të nenit 35 të Ligjit për Regjistrin e Tokës nr. 2644, personat fizikë të huaj, duke përfshirë dhe shtetasit e Kosovës, mund të fitojnë të drejtën e pronësisë së paluajtshme dhe të drejta reale të kufizuara në Turqi, me kusht që të respektohen kufizimet ligjore", shtetasit e Republikës së Turqisë mund të fitojnë të drejtën e pronësisë së paluajtshme në Republikën e Kosovës në pajtim me kufizimet e përcaktuara në Ligjin nr.08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës, i cili në nenin 5 (1) ndër të tjera përcakton: "Reciprociteti ekziston kur një shtetas i Republikës së Kosovës ose një person juridik me seli në Kosovë mund të fitojë të drejtën në pronë të paluajtshme në shtetin e shtetasit të hua nën kushte e njëjta nën të cilat shtetasit e huaj mund të fitojnë të drejtën në pronën e paluajtshme në Republikën e Kosovës".

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi iu dërgohet:

- [REDACTED]
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Sekretares së Përgjithshme;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.